



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 22.32.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË JUNIKUT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërdrejt llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Junikut, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Qerkin Morina*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga *Kapllan Muhaxheri* (udhëheqës ekipi), *Agim Sogojeva* dhe *Alban Shatri*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të auditimit *Astrit Bllaca*.

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|----|
| Përmbledhje e përgjithshme | 4 |
| 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm | 6 |
| 2 Qeverisja..... | 9 |
| 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli | 13 |
| Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit | 22 |
| Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA..... | 23 |
| Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak | 26 |
| Shtojca IV: Letërkonfirmimi | 33 |

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Komunës së Junikut (më tutje: komuna), për vitin 2016 i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 25.11.2016

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më gjerësisht shih Shtojcën 1).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare vjetore prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Si theksim i çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se disa nga pasuritë e evidentuara në kadastër nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurisë SIMFK.

Më gjerësisht, shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Kryetarit të Komunës

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Më tutje Kryetari i Komunës është zotuar që:

- ta shqyrtoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- deri në fund të muajit janar 2018, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PFV 2017 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne, gjithashtu, e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Junikut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren e MF, nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se Regjistri i Pasurive Fikse nuk konfirmon gjendjen e plotë të pasurive. Me mbështetje të DEMOS-it, komuna kishte formuar komisionin për verifikimin dhe vlerësimin e pronave. Ky komision ka verifikuar, matur dhe evidentuar në kadastër 96 parcela të tokave në sipërfaqe prej 53.5 hektarë, Shkolla fillore dhe shkolla e mesme e ulët, Bibloteka, Objekti i Qendrës të Mjeksisë Familjare, dhe shumë rrugë të cilat nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurisë në SIMFK, dhe rrjedhimisht nuk ishin prezantuar në PFV.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga komuna, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e komunës, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të komunës.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Nëse Pasqyrat Nëntëmujore Financiare janë përgatitur me kohë;
- Planin e Prokurimit për vitin 2016; dhe
- Nëse PFV janë përgatitur me kohë dhe nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Në kontekst të kërkesave për raportim, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

Draft PFV-të e vitit 2016 përmbanin gabime, për të cilat ne kemi dhënë sugjerime për t'i korrigjuar. Menaxhmenti ka marrë parasysh sugjerimet tona dhe i ka përmirësuar PFV finale, përveç të gjeturave të paraqitura si më poshtë:

- Neni 19.3.1 Raport mbi pasuritë kapitale mbi 1,000€, nuk është prezantuar vlera e tokës; dhe
- Neni 19.3.2 pasuritë jo kapitale nën 1,000€ nuk përmbajnë të dhënat për vitet 2015 dhe 2014, ndërsa neni 19.3.3 Stoqet nuk përmban të dhëna për asnjë vit.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e sipër përmendura rekomandojmë

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet e Theksimit të Çështjes. Të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të bërë regjistrimin e të gjitha pasurive kapitale. Po ashtu, duhet të sigurojë që procesi i përgatitjes së PFV-ve plotësisht adreson dobësitë e identifikuara në PFV.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për Komunën e Junikut që të menaxhoj në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vet-vlerësimit siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga komuna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- Fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm ne veçanti themelimin e komitetit të Auditimit ; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut. Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit. Zbatimi i rekomandimeve të vitit të kaluar nuk ishte në nivel të kënaqshëm. Nga gjithsej 22 rekomandimet e dhëna, vetëm gjashtë (6) ishin zbatuar plotësisht.

Komuna ka bërë një progres në menaxhimin financiar, kryesisht në reduktimin e shpenzimeve operative, në zvogëlimin e borxheve të prapambetura, si dhe veprime të mira janë ndërmarrë në ndërtimin e marrëdhënieve kontraktuese me donatorë të ndryshëm, ku ka rezultuar që pjesa e konsiderueshme e buxhetit ishte nga donatorët e jashtëm.

Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre.

Në vitin 2016, komuna ka përdorur 94% të buxhet final me një përmirësim për 3% në krahasim me vitin paraprak. Kjo tregon një trend pozitiv në menaxhimin e përgjithshëm të buxhetit.

Komuna nuk ka prezantuar edhe në këtë vit një regjistër të rreziqeve, kërkesë kjo e procedurës numër katër të dokumentit të Thesarit “Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli”.

Fusha kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime është regjistrimi i pasurive komunale.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2015, ka rezultuar me 22 rekomandime. Komuna kishte përgatitur planin e veprimit ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit për vitin 2016, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar, tetë (8) ishin në proces të zbatimit dhe tetë (8) të tjera nuk ishin trajtuar. Raporti i auditimit për PVF e vitit 2015, ishte diskutuar edhe në Kuvendin Komunal gjatë muajit tetor 2016.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën III.

Çështja 2 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

- | | |
|----------------------|---|
| E gjetura | Nga shpjegimet më lart shihet se vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar, sepse komuna nuk kishte ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar progresin e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. |
| Rreziku | Mos zbatimi i rekomandimeve ka rezultuar me dobësi të vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, që në veçanti kanë rezultuar me regjistër jo plotë të pasurive dhe mungesë të regjistrimit të rreziqeve. |
| Rekomandimi 2 | Kryetari duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka ngecje, të propozohen masat adekuate. |

2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentave të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Kemi testuar cilësinë e pyetëtorit të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuar në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur më poshtë gjetjet tona për komunën por kjo nuk ka për qëllim të ofroj komente për cilësinë e tërë pyetëtorit të dorëzuar të vet-vlerësimit, por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 – Pyetëtori i vetëvlerësimit – Prioritet i lartë

- E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetëtorit të vetëvlerësimit në lidhje me pesë komponenta. Kemi vërejtur se pyetëtori i vetëvlerësimit i plotësuar, ka konfirmuar se komuna ende nuk ka identifikuar listën e rreziqeve të cilat mund të kanosin arritjen e objektivave dhe reagimet në rast të ndodhjes së tyre.
- Rreziku** Mungesa e një regjistri të rreziqeve me të cilat mund të ballafaqohet organizata, rritë rrezikun që objektivat e përcaktuara të komunës të devijojnë nga plani fillestar, dhe si të tilla, të mos realizohen.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve dhe sigurojë që i njëjti i është deleguar për menaxhim një personi përgjegjës, i cili në mënyrë sistematike do të koordinoj masat dhe veprimet e përcaktuara me këtë dokument, si dhe do të raportoj në baza të rregullta tek menaxhmenti i komunës.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Komuna ka hartuar 15 dokumente strategjike, ku ishin përcaktuar objektivat e përgjithshme dhe përgjegjësitë për koordinimin dhe zhvillimin e planeve strategjike, si dhe llogaritjen e kostove të këtyre strategjive. Ndërlidhja e saj me kornizën afatmesme të shpenzimeve ishte mjaft e mirë. Po ashtu, edhe planet vjetore ishin të bazuara në elementet e saja. Disa prej dokumenteve të hartuara strategjike janë: Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2014-2018, Plani i menaxhimit të mbeturinave 2014-2019, Plani i Mirëmbajtjes së Hapësirave të Hapura Publike 2012-2017, Plani komunal për eficiencë të energjisë 2016-2022, Plani i zhvillimit Urban 2009-2023.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Komuna ka raporte tre mujore dhe vjetore financiare që aprovohen në Kuvendin e Komunës.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Komuna e ka të themeluar NJAB e cila funksionon me një auditor. NJAB për vitin 2016 ka planifikuar dhe ka kryer pesë (5) auditime të rregullta. Raportet janë përfunduar me kohë dhe si fusha rishikimi kanë qenë: (1) Planifikimi dhe realizimi buxhetit, (2) Të hyrat, (3) Prokurimi, (4) Procedurat e rekrutimit në drejtorinë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale dhe (5) Menaxhimi i automjeteve.

Çështja 4 - Mosfunksionimi i Komitetit të Auditimit - Prioriteti i mesëm

| | |
|----------------------|---|
| E gjetura | Komuna e Junikut edhe këtë vit nuk kishte formuar Komitetin e auditimit, siç kërkohet me udhëzimin administrativ 11/2010 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të auditimit. |
| Rreziku | Mungesa e Komitetit të auditimit mund të rezultojë me mos shqyrtimin e çështjeve të ngritura nga auditori i brendshëm, dhe me vazhdimin e praktikave joefektive, duke ndikuar dhe në mos adresimin e dobësive në kontrolle. |
| Rekomandimi 4 | Për të shtuar mbikëqyrjen e cilësisë së shërbimeve të auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të sigurojë themelimin e Komitetit të auditimit. |

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e kupton rëndësinë një sistemi adekuat dhe të fortë të kontrolleve mbi shpenzimet dhe të hyrat. Megjithatë, si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve dhe udhëzimeve, auditimi ynë ka nxjerrë në pah ekzistencën e disa dobësive në aspektin e pajtueshmërisë, që kanë të bëjnë me prokurimin, të hyrat dhe shpenzimet tjera. Kjo reflekton një mungesë të mbikëqyrjes së duhur nga komuna në fushat e përmendura. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive në përgjithësi janë të dobëta dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime janë procesi i menaxhimit dhe minimizimi i llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve, si dhe menaxhimi i të hyrave.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2016 Pranimet | 2015 Pranimet | 2014 Pranimet |
|------------------|-------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| Të hyrat vetjake | 91,000 | 91,000 | 83,989 | 77,573 | 83,865 |

Realizimi i të hyrave ishte 83,989€ apo 92% e buxhetit të planifikuar me një rritje prej 7% krahasuar me vitin paraprak. Këtu janë përfshirë edhe gjordat e gjykatave dhe dënimet e policisë. Ky nivel i inkasimit të hyrave tregon performancë të mirë. Shumica e mjeteve nga hyrat vetjake ishin shpenzuar për projekte kapitale, ndërsa pjesa tjetër është shpenzuar në kategori tjera.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2016 Realizimi | 2015 Realizimi | 2014 Realizimi |
|------------------------------|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Burimet e Fondeve: | 1,170,878 | 1,686,106 | 1,584,965 | 1,785,539 | 1,340,425 |
| Granti i Qeverisë -Buxheti | 1,079,878 | 1,190,878 | 1,179,419 | 1,241,339 | 1,174,805 |
| Të bartura nga viti paraprak | - | 16,458 | 13,442 | 20,850 | 19,116 |
| Të hyrat vetjake | 91,000 | 91,000 | 69,306 | 64,122 | 60,015 |
| Donacionet e brendshme | - | 25,000 | 4,082 | - | - |
| Donacionet e jashtme | - | 362,770 | 318,715 | 459,228 | 86,489 |

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 515,228€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore në vlerë 25,000€, donacioneve të jashtme 362,770€, dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak 16,457€, rishikimit buxhetor 40,000€ dhe vendimit të Qeverisë 71,000€.

Në vitin 2016, komuna ka shpenzuar 94% të buxhetit final, me një rritje prej 3% krahasuar me vitin 2015 (91%). Përgjithësisht, realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2016 Realizimi | 2015 Realizimi | 2014 Realizimi |
|---|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike: | 1,170,878 | 1,686,106 | 1,584,965 | 1,785,539 | 1,340,425 |
| Pagat dhe Mëditjet | 932,035 | 1,039,612 | 1,005,752 | 1,091,463 | 895,100 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 125,298 | 218,900 | 211,927 | 291,150 | 114,697 |
| Shërbimet komunale | 30,000 | 30,000 | 29,904 | 29,232 | 26,981 |
| Subvencionet dhe Transferet | 5,755 | 5,755 | 5,460 | 7,000 | 6,880 |
| Investimet Kapitale | 77,790 | 391,839 | 331,922 | 366,694 | 296,767 |

Buxheti për investime kapitale ishte rritur për 314,049€, ndërsa janë shpenzuar 85%. Pavarësisht kësaj, performanca e kategorisë së investimeve ka qenë mjaft e mirë.

Buxheti për mallra dhe shërbime është rritur për 93,602€, ndërsa janë shpenzuar 97% e ndarjes finale buxhetore.

Buxheti final për shërbimet komunale nuk kishte ndryshime me buxhetin fillestar dhe ishte shpenzuar në nivel 99%.

Komuna ka pranuar gjithashtu grante nga donatorët në vlerën 387,770€. Ekzekutimi i këtyre mjeteve ishte 83%.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2016 ishin në vlerë 83,990€, apo 92% e buxhetit të planifikuar. Krahasuar me vitin paraprak realizimi i të hyrave kishte rritje rreth 7%.

Çështja 5 - Përcaktimi i bazës për faturim të tatimit në pronë - Prioritet i mesëm

E gjetura Baza e tatimit në pronë, duke ju referuar legjislacionit në fuqi, përcaktohet nga vlera në treg e pronës. Një ndër standardet për përcaktimin e kësaj vlere është edhe cilësia e ndërtimit. Në bazë të UA nr.03/2011 cilësia e ndërtimit është e shprehur në koeficient, e cila varësisht prej gjendjes së objektit (shumë e dobët, e dobët, mesatare, e mirë dhe e shkëlqyeshme) rritë apo e zvogëlon ngarkesën tatimore). Edhe pse Zyra Komonale e Tatimit në Pronë i ka procesuar këto të dhëna në sistem, ne kemi konstatuar se kalkulimi i ngarkesës tatimore është bërë pa konsideruar cilësinë e ndërtimit. Kjo ka rezultuar që ngarkesa tatimore/faturimi e vitit 2016 të jetë mbingarkuar në vlerë totale prej 3,432€, ndërsa në anën tjetër është nënvlerësuar në vlerë prej 1,616€.

Zyra komunale e tatimit në pronë është e obliguar që çdo vit të bëjë verifikimin në terren të 1/3-ës së pronave të regjistruara, siç kërkohet me ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi. Kjo bëhet me qëllim të përditësimit të shënimeve ekzistuese. Komuna e Junikut, gjatë viti 2016 ka verifikuar vetëm 13% të numrit total të pronave (153 nga 1,146).

Rreziku Mos kalkulimi adekuat i koeficientit të cilësisë ndikon që tatimpaguesit të cilët kanë cilësi më të dobët të pronës të mbingarkohen, ndërsa tatimpaguesit me cilësi më të mirë të ngarkohen më pak se sa duhet. Mos verifikimi i pronave në terren mund të ndikojë që shënimet ekzistuese të mos jenë të sakta, dhe baza e tatueshme e pronave të jetë më e lartë apo më e ultë.

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të siguroj se me rastin e aplikimit të koeficientëve, kërkesat ligjore zbatohen me konsistencë për të shmangur mundësinë e zvogëlimit apo rritjes së pa drejtë të ngarkesave tatimore. Po ashtu, verifikimi i 1/3 të pronave për tatimin në pronë të bëhet në baza vjetore dhe në kuotat e përcaktuara me ligj.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti i planifikuar për kategorinë paga dhe mëditje ishte 1,039,612€, ndërsa shpenzimet 1,005,752€, apo 97%.

Çështja 6 – Mangësi në procesin e rekrutimit - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Për pozitën "Punëtor teknik pastrues", nuk ishin respektuar procedurat e parapara në UA 14/2011 për themelimin e marrëdhënies së punës në sektor publik. Këto procedura parashohin shpalljen e konkursit për 15 ditë në mjetet e informimit. Edhe pse Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, kishte nxjerrë një vendim për shpallje të konkursit dt. 10.11.2016, nuk janë ofruar dëshmi që konkursi ishte i shpallur në mjetet e informimit. Po ashtu, duke ju referuar UA, konkursi duhet të përsëritet nëse së paku tre kandidatë nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit. Komuna ka përzgjedhur dhe ka krijuar marrëdhënie pune për këtë pozitë, edhe pse kishte aplikuar vetëm një kandidat.
- Rreziku** Parregullsitë në procesin e rekrutimit dhe mos-shpallja publike e konkursit mund të rezultojnë në konkurrencë të padrejtë, jo transparencë si dhe në mos punësim të personelit adekuat.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të siguroj që rekrutimi i stafit të bëhet sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalit në vitin 2016 ishte 248,900€. Prej tyre ishin shpenzuar 241,631€, apo 97%, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi një ngritje të performancës prej 5% për mallra dhe shërbime dhe komunalit (në 2015 - realizimi ishte 92%).

Çështja 7 - Kontratat për shërbime të veçanta - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Komuna gjatë vitit 2016 kishte angazhuar shtatë (7) punëtorë me kontrata për shërbime të veçanta. Përkundër kërkesave nga ligji për tatime në të ardhura, asnjërit prej të angazhuarve nuk i ishte ndalur tatimi në burim, siç përcaktohet me Ligjin Nr. 05-L-028
- Rreziku** Për shkak të mos aplikimit të rregulloreve tatimore, komuna mund të jetë subjekt i ndëshkimeve nga autoritetet tatimore.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të siguroj se mbajtja e tatimeve në burim për personat e angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta, bëhet në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 5,755€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 5,460€ apo 99%. Krahasuar me vitin paraprak (2015) niveli i shpenzimit ishte i njëjtë.

Çështja 8 - Mungesa e rregullore për subvencione - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Komuna edhe këtë vit nuk ka arritur të nxjerrë rregullore të brendshme për ndarjen e subvencioneve. Në mungesë të rregulloreve, subvencionet janë ndarë në bazë të vendimeve të Kryetarit të Komunës dhe që shumica e shpenzimeve ishin për subvencionimin e klubeve të ndryshme sportive.
- Rreziku** Mungesa e rregulloreve të brendshme për ndarjen e subvencioneve krijon paqartësi në përcaktimin e kriterëve se kush mund të jetë përfitues i subvencioneve, deri në çfarë shume dhe për çfarë qëllimesh mund të jepen subvencionet.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të hartoj një rregullore për subvencione dhe të aprovohet në kuvend, e cila specifikon qartë kriteret dhe procedurat për subvencionim. Sugjerimet tona janë se shumë nga komunat i posedojnë këto rregullore, dhe të njëjtat mund të merren si model dhe të përshtaten për nevojat e komunës.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 391,839€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 331,922€ apo 85%. Krahasuar me vitin e kaluar kemi një rritje prej 9% (vitin 2015 ishte 76%).

Çështja 9 - Mos aplikimi i librit ndërtimor - Prioritet i lartë

E gjetura Tek kontrata kornizë “Rehabilitimi, Mirëmbajtja e rrugëve lokale” në vlerë 14,610€, kemi vërejtur që komuna nuk kishte aplikuar librin ndërtimor në rastin e ekzekutimit të punëve. Operatori kishte kryer me shumë punë se sa vlera e kontratës, mirëpo në mungesë të librit ndërtimor, ne nuk kemi mundur të marrim siguri nëse situacionet e paguara janë korrekte dhe pa gabime. Me ligjin e ndërtimit 04/L-110 si dhe UA 15/2013 për kushtet e mbajtjes së librit dhe ditarit ndërtimor, janë rregulluar kushtet se si duhet të administrohet libri ndërtimor dhe nga kush duhet të verifikohet i njëjti.

Rreziku Mungesa e aplikimit të librit ndërtimor dhe mos verifikimi i situacioneve dhe dakordimi i tyre me sasinë e kontraktuar, rrisin rrezikun e tejkalimit të pozicioneve të parapara në kontratë dhe mundësojnë kryerjen e pagesave shtesë dhe të parregullta.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të siguroj se me rastin e pagesave të situacioneve të ardhshme për projektet në vazhdim si dhe projektet e reja, të aplikohet libri ndërtimor dhe i njëjti të harmonizohet me situacionet për të verifikuar saktësinë e punëve të kryera dhe shumat e pagesave. Menaxherëve të projekteve tu qartësohet se aktivitetet e ardhshme duhet të jenë në pajtim me ligjin e ndërtimit (Ligji Nr. 04/L - 110) si dhe (UA 15/2013 i MMPH mbi kushtet për mbajtjen e ditarit dhe librit ndërtimor).

Çështja 10 - Keq klasifikimi i shpenzimeve - Prioritet i mesëm

E gjetura Pagesa e ekzekutuar me vendim të gjykatës në vlerë 3,898€ ishte klasifikuar si shpenzim kapital, por kjo pagesë kishte të bënte me paga dhe mëditje, sepse ishte kryer për kompensimin e dallimit në pagë të zyrtarit të auditimit.

Rreziku Përdorimi i fondeve në kundërshtim me ndarjet buxhetore, rezulton me mbivlerësimin e njëres kategori dhe nënvlerësimin e tjetres dhe mos shpalosjet e duhura ndikojnë negativisht për shfrytëzuesit informatave të PFV.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të siguroj që klasifikimi i shpenzimeve bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate të përcaktuara me planin kontabël, në mënyrë që kjo të reflektoj prezantimin e drejtë të shpenzimeve në PFV.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Në PFV komuna kishte paraqitur pasurinë mbi 1,000€ në vlerë 1,709,251€, ndërsa atë nën 1,000€, vlerën 102,607€. Të gjitha çështjet domethënëse rreth pasurisë janë trajtuar tek nën kapitulli 1.1 Opinioni i auditimit.

Çështja 11 - Dobësi në regjistrin e E - pasurisë - Prioritet i lartë

E gjetura Regjistri i E-pasurisë nuk është i saktë për arsye se blerjet nga sektori i Shëndetësisë dhe Arsimit nuk regjistrohen në këtë softuer, siç është paraparë në nenin 6, të rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive financiare.

Rreziku Mangësitë në regjistrimin e plotë të pasurisë duke mos përfshirë të gjitha blerjet, vështirësojnë identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën, prejardhjen dhe pronësinë e tyre.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të siguroj se janë regjistruar të gjitha pasuritë në modul të E-pasurisë, siç kërkohet me rregulloren 02/2013 për menaxhim të pasurisë.

Çështja 12 - Mangësi në menaxhimin e Automjeteve - Prioritet i mesëm

E gjetura Gjatë auditimit të veturave zyrtare në dy (2) raste nuk ishin plotësuar formularët për shfrytëzimin e automjeteve, siç kërkohet nga Udhëzimi Administrativ nr.03 /2008 për menaxhimin e automjeteve zyrtare. Në formularët e plotësuar mungonin kilometrat e kaluara, koha e kthimit, nënshkruesit e shfrytëzuesit të automjeteve, nënshkrimi i vozitësit, nënshkrimi i autorizuesit.

Rreziku Mungesa e raportimit për mënyrën e përdorimit të automjeteve, rrit rrezikun që automjetet të përdoren edhe jashtë objektivave zyrtare dhe mund të shkaktoj shpenzime të larta/të paarsyeshme për derivate, servisim dhe mirëmbajtje.

Rekomandimi 12 Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur kontrole për shfrytëzimin e automjeteve për të siguruar llogaridhënie adekuate nga secili përdorues i automjeteve dhe për të evituar përdorimin jo të rregullt të tyre.

3.2.2 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme në PFV në fund të vitit ishin 170,000€. Llogaritë e arkëtueshme përbehen nga tatimi në pronë dhe taksa në ushtrimin e veprimtarisë biznesore. Në përgjithësi vlera e Llogarive të arkëtueshme është rritur në krahasim me vitin e kaluar (saldo në vitin 2015 ishte 160,000€).

Çështja 13 - Trajtimi i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i lartë

E gjetura Gjatë testimit të llogarive të arkëtueshme për tatim në pronë kemi gjetur se në 13 raste vlera e borxhit të pasqyruar në kartela financiare individuale të tatimpaguesve nuk korrespondon me vlerën e borxhit të paraqitur në raportin e ngarkesës dhe inkasimit. Në këto mostra të testuara, llogaritë e arkëtueshme janë nënvlerësuar në total prej 210€. Këto diferenca ekzistojnë tek të gjithë tatimpaguesit tek të cilët vlera e borxhit në fund të vitit nuk ishte zero, prandaj vlera e përgjithshme, për të cilën llogaritë e arkëtueshme janë nënvlerësuar është 1,226€.

Rreziku Mungesa e shënimeve të sakta e llogarive të arkëtueshme, mund të sjellë deri te ngarkesat më të larta apo më të ulëta ndaj qytetarëve nëse këto nuk identifikohen me kohë, si dhe pasqyrojnë një pamje jo të drejt të këtyre vlerave në PVF.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të siguroj kontrolle më efektive të këtyre llogarive, duke i verifikuar dhe vendosur shumat e sakta, dhe pastaj të ndërmerr veprimet që sigurojnë një inkasim sa më të lartë të këtyre shumave.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 73,250€. Këto detyrime ishin për investime kapitale në vlerë 43,250€, mallra dhe shërbime 21,000€, shpenzimet komunale 9,000€, të cilat janë bartur për t'u paguar në vitin 2017.

Çështja 14 - Pagesa e obligimeve me vonesë - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas Rregullës Financiare 01-2013 të MF - Shpenzimi i parave publike, Organizata buxhetore duhet që çdo faturë të vlefshme për pagimin e mallrave dhe shërbimeve të pranuar ta paguaj brenda 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të faturës. Në bazë të raportimit në pesë (5) raste të testuara, obligimet në vlerën prej 7,275€ ishin paguar me vonesë.
- Rreziku** Vonesa në ekzekutimin e pagesave e rritë rrezikun e ekspozimit ndaj padive të mundshme, por edhe në dëmtimin e reputacionit të komunës.
- Rekomandimi 14** Kryetari duhet të siguroj se të gjitha faturat e pranuar së pari protokolohehen në librin e faturave hyrëse, dhe më pas, paguhen në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloret financiare.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

| Komponenti i Auditimit | Rekomandimet e dhëna | Të zbatuara | Në proces të zbatimit | Të pa zbatuara |
|---|---|-------------|--|--|
| 1.4 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim Rekomandimi 1 | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që është bërë një analizë për të përcaktuar arsyet për kualifikimin e opinionit të auditimit dhe paragrafin e theksimit të çështjes. Veprimi duhet ndërmarrë për të adresuar dobësitë e rëndësishme në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të zbutur dobësitë e shpalosura në paragrafin e bazës për opinion të kualifikuar. | | | PFV-të janë korrigjuar Por dobësi evidente edhe me tej është regjistrimi dhe evententimi i pasurisë . |
| 1.4 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim Rekomandimi 2 | Kryetari duhet të marrë masat e duhura për të siguruar pajtueshmëri rregullative të plotë të procesit të përgatitjes së pasqyrave vjetore financiare (PVF). Deklarata e bërë nga Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhet vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës të menaxhmentit, i ndërmarrë në përmbajtjen dhe saktësinë e PVF. | | | PVF janë dërguar në MF por pas këshillës sonë janë dërguar për korrigjim. |
| Rekomandimi 3 | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Komuna i dorëzon raportet mujore që lidhen me detyrimet e papaguara, dhe dorëzon pasqyrat financiare në gjuhën Serbe, siç kërkohet me rregulloren raportuese. | | Ne proces te implementimit pasi qe raportet për detyrime janë dërguar për çdo muaj si dhe raportet në kuvend, edhe këtë vit pasqyrat financiare ishin përgatitur vetëm ne gjuhën shqipe. | |

| | | | | |
|--|---|---|--|---|
| 3. Rekomandimet e vitit paraprak Rekomandimi 4 | Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit, zbatohet, rishikohet dhe i njëjti përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga AP, me stafin përgjegjës të emëruar për monitorim rigoroz të këtij procesi. | | Plani i veprimit ishte dërguar ne ZKA në afatin e paraparë ndërsa implimentimi për disa rekomandim ishte në proces. | |
| Lista kontrolluese e vetëvlerësimit Rekomandimi 5 | Kryetari duhet të sigurojë që lista kontrolluese e vetëvlerësimit është plotësuar me objektivitë dhe është dokumentuar për të identifikuar dobësitë dhe për ti zvogluar ato në mënyrë të përshtatshme, siç kërkohet nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës. | | Lista kontrolluese e vetëvlerësimit ishte dërguar në MF, por në disa pika nuk ishin vetëkritik duke vlerësuar me nota Maksimale. | |
| Proceset e llogaridhënies Rekomandimi 6 | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe raportimit të drejtorive komunale për të siguruar aranzhime të përmirësuara për të arritur objektivat e veçanta gjatë një viti. | Duke mare parasysh madhësinë e OB takimet me drejtoret ishin të rregullt. | | |
| 2.5.2 Menaxhimi i Riskut Rekomandimi 7 | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që procedurat dhe sistemet e menaxhimit të riskut janë krijuar dhe janë funksionale. Për më tepër, përgjegjësia për menaxhimin e riskut është deleguar direkt në një drejtori përkatëse që të sigurojë raportimin mujor mbi zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe të siguroj se risqet janë duke u menaxhuar. | | | Nuk kishte një delegim të zyrtari i caktuar përgjegjësia për menaxhimin e riskut. |

| | | | | |
|--|---|--|--|--|
| <p>Raportimi Menaxherial</p> <p>Rekomandimi 8</p> | <p>Kryetari i Komunës duhet të rishikojë masat ekzistuese të qeverisjes së përgjithshme dhe cilësinë e raportimit të brendshëm të Komunës. Kërkesat pazbatuara duhet të adresohen deri në fund të vitit 2016. Cilësia e raportimit dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të shqyrtohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar arritjen e objektivave të Komunës.</p> | | <p>Takimet e rregullta , duhet te jenë ma informues, prej planifikimit, ekzekutimit buxhetit, dhe ngecjeve të proceseve, si mos realizimi i projekteve, forma dhe mënyra e rritjes se inkasimit të të hyrave, përgatitja e PVF me cilësore, menaxhimi dhe evendentimi i pasurive komunale.</p> | |
| <p>Sistemi i auditimit të brendshëm</p> <p>Rekomandimi 9</p> | <p>Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që komiteti i auditimit është emëruar dhe kryen detyrat e veta të kërkuara nga ligji. Komiteti i Auditimit duhet të vendosë politika dhe procedura të duhura për të siguruar një standard të lartë të monitorimit dhe të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, në procesin e raportimit financiar dhe mbikëqyrjen e punës së departamentit të auditimit të brendshëm. Për më tepër, Kryetari duhet të sigurojë që aktiviteti i ardhshëm i AB të udhëhiqet në drejtim të zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit të bazuar në risk. Për më tepër, në mënyrë që përfitimet të jenë të dukshme, Kryetari duhet të marrë masa për zbatimin e të gjeturave të AB-së brenda Komunës.</p> | | <p>Edhe pse njësia e auditimit ka kryer auditime duke e përmbushur planin e auditimit, Komuna e Junikut edhe këtë vit nuk kishte formuar Komitetin e auditimit.</p> | |


| | | | | |
|--|--|---|--|---|
| Realizimi i buxhetit Rekomandimi 10 | Kryetari i Komunës duhet në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme të monitorojë performancën buxhetore, të identifikojë dhe adresojë pengesat për të planifikuar nivelet e realizimit të buxhetit. Kryetari duhet të sigurojë që plani i zbatimit për të hyrat vetanake përbën një plan realist dhe përkon me aftësitë e Komunës për të mbledhur të hyrat. Për më tepër, duhet të sigurohet se | | Ka një progres në realizimin e buxhetit nga kategoritë e të hyrave ,por ende ka ngecje nga realizimi i donacioneve. | |
| Prokurimi Rekomandimi 11 | Kryetari duhet të identifikoj shkaqet rrënjësore të mangësive dhe të ndërmarrë masat e duhura për të siguruar se kërkesat e ligjit te prokurimit janë zbatuar plotësisht. | | Duke e krahasuar me vitin paraprak ka një progres .Kontratat nuk ishin nënshkruar pa zotimin apo sigurimin e disponishmeris se mjeteve, menaxhimi i kontratave edhe me teje është një sfide e komunës. . | |
| Shpenzimet tjera Rekomandimi 12 | Kryetari duhet të siguroj që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat, që ato të jenë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret përkatëse. | | | Ne baze te mostrave ne kemi vrejtur edhe me teje pagesa pa raporte te pranimit te shërbimeve. |
| Dosjet e Personelit Rekomandimi 13 | Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi dosjet e personelit në mënyrë që dosjet të jenë të kompletuara dhe organizuara mire, dhe të marrë masa në lidhje me nënshkrimin e listës së pagave. | Ka ne përparim të dukshëm në këtë drejtim | | |

| | | | | |
|---|---|----|--|--|
| Subvencione dhe Transfere Rekomandimi 14 | Kryetari duhet të sigurojë që Komuna të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi subvencione dhe transfere në mënyrë rigoroze dhe në përputhje me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale. | | | Nuk ishte aprovuar edhe me teje rregullorja e subvencioneve. |
| Të hyrat nga tatimi në pronë, nga qiraja dhe të hyrat tjera Rekomandimi 15 | Ne rekomandojmë Kryetarin të ndërmarrë këta hapa: Të ndërmarr hapa për të përmirësuar sistemin e faturimit, dhe të kontabilitetit në mënyrë që të sigurojë kontrolle efieçiente dhe efektive në faturim, dhe në të hyra. Përmirësimi i procedurave lidhur me sisteme të tilla do të mundësonte menaxhmentin të monitoroj dhe menaxhoj reziqet e mëdha, dhe të siguroj që vendimet lidhur me buxhetimin, planifikimin dhe arkëtimin e të hyrave bëhen në mënyrë të duhur. Të sigurohet që ankëtimet, vlerësimi dhe kushtëzimi i provizionimit të shërbimeve bëhet siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2011 dhe Nr. 07/2011 dhe 04/2011. | PO | | |
| Regjistri i pasurisë kapitale Rekomandimi 16 | Kryetari duhet të sigurojë regjistrimin në kohë dhe të saktë të të gjitha pasurive në regjistrat përkatës, në përputhje me kërkesat e rregullores 02/2013. Ai gjithashtu duhet të sigurojë që pasuritë kapitale të cilat regjistrohen përmbajnë informacion të plotë, duke përfshirë datën kur pasuria është vënë në përdorim, në mënyrë që llogaritja e zhvlerësimit të mund të kryhet me saktësi. Si dhe të përcaktojë statusin e pronësisë. | | | Nuk ishte implementuar , edhe me tej shume nga pronat komunale mbetet e pa evidentuar, dhe prezantuar ne PVF.. |

| | | | | |
|---|--|---|---|--|
| Inventarizimi i pasurisë kapitale Rekomandimi 17 | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që inventarizimi i pasurive kapitale jo-financiare është kryer në pajtim me Rregulloren në fuqi për pasuritë jo-financiare të Organizatës Buxhetore dhe të siguroj se inventarizimi bëhet në baza vjetore. | Po ishin formuar komisionet e inventarizimit. | | |
| Shpaloja e pasurisë jo-kapitale nën 1,000 euro Rekomandimi 18 | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Komuna mban informacion të saktë dhe të plotë në lidhje me pasuritë jo-kapitale dhe të siguroj se ato janë të prezantuara në pasqyrat financiare. | | Përpos shpalojes se pasurisë nën 1,000Euro në drejtorin e arsimit dhe QKMF në të tjerat ishin bere shpalojet e nevojshme. | |
| Mungesë e dokumentacionit të pronësisë dhe informacioneve për investimet e bëra nga palët e treta Rekomandimi 19 | Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se Komuna është duke bërë përpjekje maksimale për sigurimin e të dhënave nga palët e treta, me theks të veçantë në ato palë që dihet se kanë kryer investime të rëndësishme në Komunë. Të dhënat e marra duhet të paraqiten siç duhet në regjistrin e pasurive të Komunës. Praktika më e mirë do të kërkojë një barazim vjetor bazë të të dhënave në mes të palëve të treta dhe Komunës për investime në Komunë për vitin përkatës. | PO | | |
| Depozitimi i parasë së gatshme Rekomandimi 20 | Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se depozitat e përditshme të parasë dhe kontrollet janë kryer ashtu siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi. | PO | | |

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| Vjetërsia e të arkëtueshmeve Rekomandimi 21 | <p>Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që llogaritë e arkëtueshme janë shpalosur në mënyrë efikase dhe të detajuar, dhe për to mbahen dokumente dhe informacione të mjaftueshme. Për më tepër, Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që Komuna do të marrë veprime të mëtejshme për arkëtimin e të hyrave dhe se ekzistojnë kontrollet e nevojshme të cilat sigurojnë që balancat e vjetra të shpalosura do të arkëtohen nga palët respektive.</p> | | | <p>Mos minimizimi i të arkëtueshmeve ka vazhduar edhe këtë vit.</p> |
| Borxhet e papaguara Rekomandimi 22 | <p>Kryetari duhet të sigurojë që Komuna do të ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm dhe të zhvilloj plane veprimi për të bërë pagesat brenda periudhës së kërkuar.</p> | | | <p>Ne bazë të PVF ne kemi vërejtur se edhe me teje ka fatura të cilat nuk ishin paguar në afatin ligjor.</p> |

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit
Vendi dhe data: Junik, 24.04.2017

I nderuar,
Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Junikut, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari:
Agron Kuçi

